



Reconstruction Implementation Commission  
for Serbian Orthodox Religious Sites in Kosovo

## KOMUNIKATË PËR SHTYP- 2 tetor 2007

KIR shpreh brengën e tij në lidhje me mënyrën në të cilën janë zhvilluar aktivitetet në tërësinë e Tempullit Sinodal Shënteshës në Gjakovë, të cilat kanë filluar pa konsultime paraprake zyrtare, në të cilat do të përfshihej KIR. Tërësia e Tempullit Sinodal Shënteshës, gjendet në listën e monumenteve dhe tërësive të dëmtuara më 2004, për të cilat KIR mbanë përgjegjësinë për të mbikqyrur procesin e rindërtimit.

KIR është mirënjohës për iniciativën pozitive të ndërmarrë nga Komuna e Gjakovës për largimin e mbeturinave nga tërësia, të cilat vetvetiu krijojnë rreziqe të mëdha shëndetësore për popullatën lokale. Sidoqoftë, pasi që kjo iniciativë nuk ka marrur në konsideratë implikimet e mundshme për këtë tërësi- me kërkesë të UNMIK- autoritetet lokale komunale kanë ndërprerë të gjitha punët pastruese deri në njoftimin tjetër.

KIR i cili është një trup menaxhues i cili përfaqëson pesë institucione dhe mbështetet në vendimet politike për të implementuar aktivitetet e tij. Është thelbësore pajtueshmëria e plotë e të gjitha palëve të interesuara drejtpërsëdrejti, në mënyrë që KIR të sigurojë mbështetje të vazhdueshme dhe suksese në projektet rindërtuese, si deri më tani. Veçanërisht në relacion me tërësitë e ndieshme si Tempulli Sinodal Shënteshës, KIR inkurajon vendim-marrësit të gjejnë një kompromis dhe të lejojnë atë të vazhdojë me përgjegjësitë që ka, sa më përshtatshëm, aq sa mekanizmi i KIR lejon.

Në takimin e tij plenar në shtator 2007, KIR ka vendosur të kërkojë nga UNMIK organizimin e një takimi me qëllim të dakordimit, në nivel politik, të strategjisë për pastrimin dhe sigurimin e kësaj tërësie të ndieshme. KIR mëson se një takim i tillë i të gjitha palëve të interesuara është planifikuar në hapat e ardhshëm të nevojshëm për të lëvizur para me procesin. Në ndërkohë, KIR vazhdon aktivitetet e tij rindërtuese në disa rajone në Kosovë, dhe ka për qëllim të përfundojë punët në dymbëdhjetë tërësi religjioze Serbe Ortodokse, deri në pranverë 2008.

